



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë më, ____ . ____ . 2026

FTESË PËR NEGOCIATË

Të nderuar,

Mbështetur në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në VKM nr. 1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radioteleviziv ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”,

Objekti i programit/spotit/reklamës: “Informimin e tatimpaguesve mbi lehtësitë e reja tatimore për fermerët dhe individët përfitues”.

Nevoja për kryerjen e reklamave: Me anë të kësaj fushate komunikimi do të bëhet i mundur realizimi i objektit: “Informimin e tatimpaguesve mbi lehtësitë e reja tatimore për fermerët dhe individët përfitues”, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tatimpaguesve mbi lehtësitë fiskale në fuqi.

Të zhvillohet procedura e blerjes, zhvillimit dhe prodhimit të spoteve/reklamave: “Informimin e tatimpaguesve mbi lehtësitë e reja tatimore për fermerët dhe individët përfitues”, me fond limit 4,016,666.6 (katër milion e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtë) lekë pa TVSH.

Krijimi i spotit informues të kryhet nga organet e medias të specializuara në këtë fushë dhe transmetimi të kryhet nga media on-line, sipas specifikimeve të mëposhtme:

1. Prodhim dhe transmetim spotesh 2 (dy);
2. Përgatitje e konceptit krijues dhe skenarëve të spoteve;
3. Operatori ekonomik duhet të përdorë muzikë me të drejta autori (copyright);
4. Operatori ekonomik duhet ta realizojë me zë narrator;
5. Toni i zërit të jetë pozitiv dhe mbështetës, për një qasje të qartë dhe motivuese;
6. Spoti duhet të shoqërohet me sloganin e fushatës (nëse ka), logon e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Ministrisë së Financave;
7. Kohëzgjatja e Spoteve televizive 60 sekonda secili;
8. Transmetimin e spoteve në 2 media audiovizive;

- Scan TV për shkak se lidhet me profilin e tij ekonomik dhe financiar, si dhe natyrën e informacionit që synohet të transmetohet;
- Euronews Albania për shkak se është një televizion informativ që funksionon si franchse i rrjetit ndërkombëtar të lajmeve Euronews, media ndërkombëtare e pranishme në shumë gjuhë dhe vende të botës.

9. Periudha e transmetimit 10 ditë (në secilin televizion);

10. Frekuenca: Spotet të transmetohen në një axhendë tre mujore, me fashë orare brenda orës 15:30-20:00;

Axhenda e transmetimit në 3 muaj, shpërndarë si më poshtë:

- Java e parë e muajit Prill: 3 ditë në Scan TV
- Java e dytë e muajit Prill: 3 ditë në Euronews Albania
- Java e parë e muajit Maj: 3 ditë në Scan TV
- Java e dytë e muajit Maj: 3 ditë në Euronews Albania
- Java e parë e muajit Qershor: 4 ditë në Scan TV
- Java e dytë e muajit Qershor: 4 ditë në Euronews Albania

➤ **Dokumente ligjore që duhen paraqitur, si kriter kualifikues:**

- Ekstrakt historik i QKR, që vërteton se Operatori Ekonomik ushtron aktivitet ekonomik tregtar që përputhet me objektin e procedurës dhe është aktiv;
- Dokument nga organet kompetente që vërteton se operatori ekonomik ka shlyer detyrimet fiskale, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën koherente;
- Vërtetim të xhiros vjetore të realizuar për vitin 2025;
- Vërtetim mbi gjëndjen gjyqësore (certifikatë e gjëndjes gjyqësore).

➤ **Dokumentacioni financiar, si kriter kualifikues:**

- Vërtetim nga banka për numrin e llogarisë bankare së bashku me nr. IBAN;
- Kontratë të ngjashme të realizuar gjatë tre viteve të fundit me shtetin (referencë ose kontratë) dhe/ose me subjekte private (faturat përkatëse dhe/ose kontrata);
- Sigurimin e ofertës në masën 2% të vlerës së fondit limit;
- Deklaratën që subjekti nuk është në konflikt interesi;
- Deklaratën që i përmbush specifikimet dhe termat e referencës;
- Deklaratë konfidencialiteti;
- Formularin e ofertës;
- Media plan paraprak për shpërndarjen/transmetim;
- Deklaratë nga operatori ekonomik që transmetimi i reklamës do të jepet nga organet e masmedias, të cilat janë aktive dhe të licensuara sipas legjislacionit në fuqi.

Mosplotësimi i kriterëve të mësipërme përbën kusht për skualifikimin e ofertuesit. Dokumentacioni të jetë origjinal ose kopje e noterizuar dhe duhet të jetë lëshuar brenda tre muajve nga data e zhvillimit të procedurës.

Oferta duhet të jetë origjinale si dhe dokumentacioni i kërkuar më sipër duhet të jenë të futur në zarf jo transparent, të mbyllur, të vulosur dhe të firmosur me emrin dhe adresën tuaj. Mbi zarf të jetë shënuar “**Ftesë për Negociatë**”.

Ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarf, të vulosura dhe do të dorëzohen nga përfaqësuesit e shoqërive zyrtarisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në datën **09.03.2026, ora 15:00**.

Në procesin e hapjes së ofertave kanë të drejtë të marrin pjesë Ofertuesit, apo personat me autorizim.

Komisioni pret konfirmimin nga operatorët ekonomik për vazhdimësinë e negociatave, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociatë.

Komisioni nuk do të pranojë asnjë ofertë jashtë këtij afati dhe jo në përputhje me kërkesat e mësipërme.

Pas analizimit të ofertave, të paraqitura nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara, komisioni përzgjedh ofertën më të ulët të paraqitur nga organet e masmedias/agjencitë e specializuara.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.